

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 107/2016, “PËR PREFEKTIN
E QARKUT”, TË NDRYSHUAR”

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e qarkut”, të ndryshuar”

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektaktit, kryesisht mbi:

- efektet e mundshme në zbatimin praktik nga institucionet përkatëse;
- çdo aspekt që mund të ndihmojë në rritjen e efektivitetit dhe zbatueshmërisë së projektaktit në praktikë.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektvendimit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 20 ditë pune, nga data 18 dhjetor 2025 deri më 15 janar 2026.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjit, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>;
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Sara Shameti, në adresën: Sara.Shameti@mb.gov.al

Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Znj. Sara Shameti - Koordinatore e Konsultimit Publik, e-mail: Sara.Shameti@mb.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Takimet janë zhvilluar në ambjentet e punës së Ministrisë së Punëve të Brendshme ndërmjet drejtorisë teknike, atë të Drejtorisë së Politikave dhe Koordinimit për Menaxhimin e Territorit dhe Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore.

Sfondi i propozimit legjislativ:

Gjatë zbatimit të ligjit aktual “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar, janë evidentuar problematika që lidhen me koordinimin ndërmjet institucioneve qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore; qartësinë dhe ndarjen e kompetencave ndër-institucionale; mungesën e rregullimit të detajuar për koordinimin në zonat bregdetare; nevojën për forcimin e rolit të Policisë Bashkiake në bashkëpunim me prefektin; përmirësimin e mekanizmave të raportimit dhe monitorimit në territor.

Problematikat e konstatuara dhe nevoja e krijimit të Prefektit Detar, adresohen me përmirësime të ligjit aktual “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar.

Propozimet:

- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore për çështje të sigurisë dhe administrimit territorial.
- Forcimi i rolit të prefektit në koordinimin me Policinë e Shtetit dhe Policinë Bashkiake.
- Marrja e një roli edhe më gjithëpërfshirës për bashkërendimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore mbi problematikën lidhur me emergjencat civile.
- Rritja e koordinimit ndërmjet institucioneve qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore në nivel qarku dhe në zonat bregdetare.
- Raportim më i strukturuar pranë Këshillit të Ministrave mbi zbatimin e politikave shtetërore, veçanërisht atyre të planifikimit të territorit, menaxhimit të bregdetit dhe sigurisë së plazheve.
- Rritje e efektivitetit në menaxhimin e emergjencave civile.

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projektligjit të propozuar. Për më tepër, ne kemi zgjedhur pyetjet e mëposhtme ku kontributi juaj do të jetë veçanërisht i vlefshëm, dhe të cilave mund t'i përgjigjeni duke plotësuar një pyetësor të shkurtër në internet.

- Si mendoni se mund të ndikojë ky projektligj në:

a. Kontributin që Prefekti i qarkut do të ketë në bashkëpunimin e administratës lokale me qytetarët?

b. Si do të ndikojë ky projektligj në përfaqësimin më të mirë në interesat dhe shqetësimet e ndyshme të komunitetit?